



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM

Duke u bazuar në nenin 68 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, paraqet këtë:

RAPORT

(Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025)

Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim me datë 17.08.2022 ka mbajtur diskutimin publik "Planifikimi i buxhtit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025", diskutimi është mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal nga ora 14:00.

Gjatë diskutimit ishin prezent Ibush Mjekiqi nënkryetari i komunës, Vlora Mjekiqi Kabashi – kryesuese e kuvendit, Zarife Behluli – drejtoreshë e DEFZH-së dhe pjesëtarë të tjerë të ekzekutivit komunal.

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 30 qytetarë, prej tyre 14 gra dhe 16 burra.

Pas prezantimit të Planifikimit të buxhetit për vitin 2023 dhe planifikimit për vitet 2023 dhe 2024, kemi pranuar tri kërkesa nga qytetarët:

- Daut Mustafa fshati Plemetin, kemi ardhur të ankohe mi për trafon, sepse kemi shumë probleme shkaku i rrymës së dobët, rreth 30 shtëpi janë me banorë të komunitetit rom që në mbrëmje nuk kanë energji elektike të fortë. A do të bëhet ndonje zgjidhje?
- Skender Berisha, përfaqësues i lagjes Sokoli prioritet kemi trafon, mirpo kemi edhe probleme me rrjetin e kanalizimit, gjithashtu edhe me asfaltim ku është përgatitur rruga por nuk është asfaltuar ende?
- Abdyl Mustafa, përfaqësues i komunitetit rom pajtohem me kërkesat e parafolësve, fshati Plemetin ka shumë nevojë për investime si në rrugë, asfaltim, ndriçim, ka shumë shtëpi ndërsa kapaciteti i energjisë elektike është shumë i vogël.

- Nënkryetari Ibush Mjekiqi, do t'i përgjigjem (3) tri pyetjeve, sa i përket rregullimit të trafteve, te shpërndarja e energjisë elektrike ekziston një kompani që bënë shpërndarjen e energjisë elektrike dhe në mënyrë të vazhdueshme po tentojmë të punojmë në këtë drejtim. Sa i përket investimeve kapitale e pyesim drejtorin e infrastruktures se ku jemi me procedura!
- Fatmir Bërbatovci, drejtori i infrastruktures, rruga përball banesave tek hekurudha, është në procedura të tenderimit vetem se jemi duke i pritur afatet e procedurave të tenderimit.

Nënkryetari Ibush Mjekiqi, këtë vit do të rregullohet edhe hapsira rreth banesave shumë shpejt do të vijmë edhe deri te nënshkrimi i kontratës. Gjithashtu këtë vit është plaifikuar edhe ndërtimi i urës në Plemetin, buxheti i komunës është i paraparë për të gjithë komunën pa dallim si në vendbanimet e tjera edhe në Plemetin.

Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim, diskutimi publik ka përfunduar në ora 14:25.

Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq
12.09.2022



Zyrtar përgjegjës për konsultime publike
Festina Preniqi dhe Flaka Hashani